



Prishtinë: 18.09.2008

Kodi i ZRRE-së: V\_120\_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_120\_09\_08

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_120\_09\_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2008 nxori këtë:**

### VENDIM

**PRANOHET** ankesa e konsumatorit **RrKTT** (shifra e konsumatorit (DPR – 9024805) në fshatin Zatriq Rahovec, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së të ZRRE-së të datës 21.12.2007 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 07.02.2008, lidhur me ngarkesën e KEK-ut bërë konsumatorit.

- Me datë 01.12.2006 Rrjeti Kosovar për Telekomunikacion Tokësor (RrKTT) iu është drejtuar KEK-ut me një kërkesë me anë të së cilës duhet të justifikohet pronësia e RrKTT mbi linjat e tensionit energjetik me destinim në punktet në Golesh, Zatriq, Cërrnushë, Maje të gjelbër dhe Butovë, ngase sipas RrKTT shpesh ndodh që konsumatorët kyçen në rrjetin e tyre me pretekstin se kanë pëlqimin e KEK-ut.

**Provë:** Kërkesa me shkrim e RrKTT e datës 01.12.2006

- Me datë 01.12.2006 KEK-u iu është përgjigjur RrKTT me anë të një njoftimi me anë të së cilës KEK-u nuk jep asnjë pëlqim elektroenergjetik për kyçje në rrjet ndonjë konsumatori pa pëlqimin edhe të RrKTT, pra që nevojitet pëlqimi i RrKTT dhe i KEK-ut për dhënie të pëlqimit elektroenergjetik për kyçje në rrjet.

**Provë:** Njoftimi i KEK-ut për RrKTT me datë 01.12.2006



- Sipas deklaratave të konsumatorit dhe një raporti të brendshëm të RrKTT i përpiluar gjatë muajit mars 2007 është theksuar se në fund të muajit Shkurt 2007 ka ndodhur një zbrastje atmosferike në linjën tensionit të lartë në Zatriq dhe se përfaqësuesit e RrKTT së bashku me përfaqësuesin e firmës "AFION" e cila ka qenë përgjegjëse për kryerjen e punëve rreth energjisë elektrike kanë dalur në vendin e ngjarjes me ç'rast nga përfaqësuesit e firmës "AFION" është konstatuar se transformatorët matës rrymor (TMRR) janë dëmtuar dhe se janë zëvendësuar TMRR me TMRR të ri.

**Provë:** Raport i brendshëm i RrKTT mbi gjendjen e TMRR

- Me datë 01.03.2007 firma 'AFION' ka përpiluar një Proces pune me anë të së cilës është theksuar se me anë të kërkesës së RrKTT është bërë ndërrimi i TMRR nga 400/5 A në 100/5, në transformatorin e punktimit të antenave në Zatriq – Rahovec.

**Provë:** Proces pune e datës 01.03.2007

- Me datë 04.07.2007 KEK-u – Divizioni i Rrjetit në Prishtinë ka përpiluar raportin nr. 1621 me anë të së cilës është bërë kontrollimi detal i grupit matës të RrKTT – Zatriq. Në raportin e KEK-ut janë marrë të dhënat e grupit matës të konsumatorit dhe se tek vërejtja është theksuar se: konstanta llogaritëse e energjisë elektrike është  $C=20$ , TMRR – 100/5, ndërsa është duke u kalkuluar me konstante  $C=80$ . Poashtu është theksuar se numri i njehsorit nuk përputhet me ato të dhënave të programit të KEK-ut CCP dhe se ekipi i KEK-ut ka konstatuar se numri i njehsorit është 17707810.

**Provë:** Raporti i KEK-ut nr. 1621 i datës 18.10.2007

- Me datë 10.07.2007 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK lidhur me korrigjimin e faturave të muajit: Mars, Prill, Maj dhe Qershor 2007.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK

- Me datë 07.12.2007 KEK-u iu është përgjigjur konsumatorit duke e pranuar pjesërisht ankesën e konsumatorit dhe duke e bërë korrigjimin e faturave 7, 8, 9, 10, 12/07 e cila vlerë e korrigjuar e shprehur financiarisht është 17,271.34 €.

**Provë:** Përgjigja e KEK-ut

- Me datë 21.12.2007 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit drejtuar në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK Sh.A dhe konsumatorit i rekomandon Bordit të ZRRE që të **pranojë** ankesën e konsumatorit për shkak të arsytimeve të paraqitura:



1. KEK- u ka bërë korrigjimin e faturave vetëm prej periudhës 04 Korrik 2007 e deri më 11/2007 sipas raportit të KEK-ut nr. 1621 të datës 04.07.2007.

**Provë:** Përgjigja e KEK-ut dhe Raporti i KEK-ut nr. 1621

2. KEK-u ka vazhduar të faturojë konsumatorin me konstante 80 siç shihet edhe në faturat e muajit 08, 09, 10, 11/2007 edhe pse raporti i KEK-ut mbi kontrollimin detal të grupit matës është bërë me datë 04.07.2007.

**Provë:** Faturat e KEK-ut të periudhave 08, 09, 10, 11/2007 dhe Raporti i KEK-ut i datës 04.07.2007.

3. KEK-u ka vazhduar të faturojë konsumatorin me konstante 80 edhe në muajin 12/2007 edhe pse konsumatori ka bërë ankesë në KEK për korrigjim të faturave në muajin e 10/2007.

4. KEK-u ka korrigjuar faturat e energjisë elektrike prej muajit 07/2007 e deri 11/2007 duke u bazuar në raportin e KEK-ut nr. 1621 të datës 04.07.2007, pra që nuk ka marrë për korrigjim faturat e mëhershme në arsyetimin se RrKTT nuk posedon ndonjë dokument zyrtar me anë të së cilës do të mund të vërtetohej se TMRR janë zëvendësuar në mars të vitit 2007.

5. Sipas transaksioneve të konsumatorit shihet qartë se faturat e energjisë elektrike dukshëm janë rritur prej Marsit 2007 e tutje.

**Provë:** Transaksionet e konsumatorit

6. Sipas listave të leximit të KEK-ut të periudhave prej 02/2007 e deri 12/2007 shihet qartë se prej periudhës 03/2007 shpenzimi i energjisë elektrike dukshëm është rritur e kjo vërehet edhe në transaksionet e konsumatorit.

Nga faktet paraqitura më lartë për konsumin e konsumatorit, DMK vjen në konstatim se konsumatori ka bërë ndërrimin e transformatorit matës që nga muaji Mars 2007 dhe se konstanta e këtij grupi matës nga ky muaj ka qenë  $C=20$ . Lexuesi i KEK-ut nuk ka bërë lexim të rregullt dhe njëkohësisht nuk e ka lexuar saktë grupin matës.

DMK i rekomandon Bordit që të **pranohet** ankesa e konsumatorit dhe që KEK-u ta rillogarisë energjinë e konsumuar të konsumatorit për muajin e 3, 4, 5, 6 duke marrë për konstante të grupit matës konstanten  $C=20$ .

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së. Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:



1. KEK-u është i obliguar që të rillogarisë energjinë e konsumuar të konsumatorit për muajin e 3, 4, 5, 6 të vitit 2007 duke marrë për konstante të grupit matës C=20.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Nysret Avdiu, anëtar